



GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Buletini Informativ

Publikuar nga:



Published by



1 korrik 2015 - 1 janar 2016

Fjala e Kryetares	3
Raporti gjashtëmuor i punës	4
Vizitat dhe aktivitetet e Gjykatës	7
Përvojat dhe praktikat personale	9
Komisioni i Venecias - Ngjarje me rëndësi	11
Aktgjykimet	12
Kush mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese?	14
Parashtrimi i kërkesës	15
Informata për Gjykatën	16

Kushtetuta e Kosovës – Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën

2. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbejnë për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Aktualisht, Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë: 6 (gjashtë) gjyqtarë vendorë dhe 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë.



Kam kënaqësinë t'ju prezantoj numrin e parë të Buletinit Informativ të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që tash e tutje do të publikohet çdo gjashtë muaj.

Buletini Informativ do t'ju ofrojë lexuesve informata të përmbledhura dhe të dobishme përkitazi me punën dhe me aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese, duke pasur në fokus vendimet më të rëndësishme, konferencat dhe punëtoritë e organizuara, vizitat dhe takimet e realizuara në vend dhe jashtë vendit, të dhënat statistikore për numrin e kërkesave të parashtruara dhe seancat e mbajtura, intervistat e rrëfimet personale, si dhe shumë informata të tjera me interes të veçantë për pjesëtarët e komunitetit juridik në Kosovë, dhe jo vetëm.

Buletini Informativ është pjesë e strategjisë sonë të re për transparencë dhe për komunikim më të mirë me publikun, të cilin shpresojmë se çdo lexues do ta konsiderojë si burim të vlefshëm për punën, për angazhimet dhe për njohurinë e tyre.

Ne jemi të përkushtuar për ta bërë Buletinin Informativ sa më të arritshëm për të gjithë lexuesit e interesuar. Buletini, përveç se do të botohet në tri gjuhë (shqipe, serbe dhe angleze), do të publikohet edhe në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës: www.gjk-ks.org.

Ju lutem, mos hezitoni ta kontaktoni Gjykatën Kushtetuese për çdo propozim që mund të keni përkitazi me informatat e prezantuara në Buletinin Informativ, me qëllim që përmbajtja e tij të jetë më e begatshme dhe me qëllim që të përmbushë çdo kriter tuajin për lexim, duke dërguar sugjerimet eventuale në adresën elektronike të Gjykatës: gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të veçantë për Agjencinë gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), me përkrahjen e së cilës është bërë i mundur publikimi i numrit të parë të Buletinit Informativ të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Singerisht,

Arta Rama-Hajrizi

Kryetare



Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmuajore (1 korrik – 31 dhjetor 2015), Gjykata ka pasur në punë gjithsej 188 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 87 kërkesa janë zgjidhur ose 46.3% e të gjitha rasteve në disponim.

Gjatë vitit të kaluar 72 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë proceduar te palët, ndërsa 15 kërkesa të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.

Parashtrimi i kërkesave

Juridiksioni dhe palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është i përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Besimi i qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese është rritur dukshëm si rezultat i punës efikase, efektive dhe të paanshme. 74 kërkesa janë pranuar gjatë kësaj periudhe, që do të thotë se janë pranuar mesatarisht 12.3 kërkesa në muaj.

Struktura e kërkesave të parashtruara është:

67 kërkesa individuale (nga personat fizikë), ose 90.5%;

7 kërkesa nga Autoritet të tjera publike (personat juridik) ose 9.5%;

Shpërndarja e kërkesave

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Departamenti i Regjistrimit të Lëndëve, Statistikës dhe Arkivit (DRLSA) i ka proceduar të gjitha kërkesat e parashtruara sipas nenit 13 të Kushtetutës.

Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për Gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullin 8 dhe 34 të Rregullores së punës të Gjykatës. Përfundimisht nga ky rregull është shpërndarja e kërkesave për vënien e Masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, dhe rasteve ad hoc, të cilat paraqesin konflikt interesi, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Gjykatat dhe në pajtim me rregullin 7 të Rregullores së punës.

Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës


Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike a fetare, kanë qasje të barabartë në Gjykatën Kushtetuese.

Qasja e individëve tregohet me sa vijon:

57 kërkesa nga shqiptarët, ose 77.0%;

10 kërkesa nga serbët, ose 13.5%;

7 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet të tjera publike (personat juridik) ose 9.5%



Shkeljet e supozuara, sipas llojit të shkeljeve

Tipologjia e shkeljeve të supozuara nga 74 kërkesat e pranura gjatë periudhës gjashtëmuajore (1 korrik – 31 dhjetor 2015) është si në vijim:

Neni 21 [Parimet e përgjithshme], 4 raste, ose 5.4%;

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare], 1 rast, ose 1.4%;

Neni 24 [Barazia para ligjit], 13 raste, ose 17.6%;

Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 25 raste, ose 33.8%;

Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 19 raste, ose 25.7%;

Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 4 raste, ose 5.4%;

Neni 51 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale], 1 rast, ose 1.4%;


Neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], 3 raste, ose 4.1%;

Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të institucioneve shtetërore, 1 rast, ose 1.4%

Shkelje të tjera, 3 raste ose 4.1%

Struktura etnike e paraqitësve të kërkesave paraqitur në numër dhe përqindje është si në vijim:

Struktura e paraqitësve të kërkesave



Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

69 ose 93,2 % kërkesa kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;

5 ose 6,8 % kërkesa kanë të bëjnë me autoritetet e tjera publike;



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë periudhës gjashtëmuajore (1 korrik – 31 dhjetor 2015) Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 17 seanca plenare dhe 85 kolegje shqyrtuese, në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me vendime, aktvendime, aktgjykime dhe masa të përkohshme:

3 Aktgjykime

75 Aktvendime

2 Vendime për masë të përkohshme

4 Vendime për heqje të kërkesës nga lista


1 Vendim për hedhje poshtë të kërkesës

Nga fusha e trajnimeve dhe zhvillimit të karrierës janë kryer këto aktivitete:

Në këtë periudhë janë mbajtur:


- punëtori jashtë vendit (1)
- vizita studimore jashtë vendit (4)
- seminare brenda vendit (1)
- trajnime brenda vendit (8)
- trajnime jashtë vendit (1)
- tryezë e përbashkët jashtë vendit (1)
- kurs i gjuhëve të huaja (1)

SHKELËSIT E SUPOZUAR TË TË DREJTAVE



■ Gjyqësori (93,2 %)
■ Autoritetet tjera publike (6,8 %)

STRUKTURA E VENDIMEVE NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE



16 shtator 2015

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama - Hajrizi, qëndroi për vizitë zyrtare në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë. Kryetarja Rama - Hajrizi u prit nga homologu i saj, z. Bashkim Dedja.

16 tetor 2015

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës shënoi Vitin e Gjashtë Gjyqësor me një ceremoni solemne të organizuar në Prishtinë.

Në këtë solemnitet morën pjesë delegacionet e nivelit më të lartë të Komisionit të Venecias, të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, të Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, të Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë, të Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, të Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë dhe të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë.

Pjesëmarrësve në këtë ceremoni, me një fjalim rasti iu drejtuan kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, kryetari i Komisionit të Venecias, z. Gianni Buquicchio.



19 - 23 tetor 2015

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar (IRZ), realizoi një vizitë studimore të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në Gjermani.

Gjatë qëndrimit në Karlsruhe të Gjermanisë, kryetarja znj. Arta Rama Hajrizi dhe delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u takuan me zëvendëskryetarin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, prof. dr. Ferdinand Kirchhof, si dhe me gjyqtarët e tjerë, prof. dr. Andreas L. Paulus, prof. dr. Doris König, dhe prof. dr. Susanne Baer.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese zhvilloi takime edhe me gjyqtarët e Gjykatës Supreme Federale në Karlsruhe, si dhe me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Landit Hesse, Dr. Günter Paul, në Wiesbaden të Gjermanisë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave të ndërsjella në raportet ndërmjet gjykatave kushtetuese dhe gjykatave supreme të të dyja vendeve.

Vizita u mundësua me përkrahjen e Fondacionin Gjerman për Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar (IRZ).

28 - 30 tetor 2015

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, organizoi tryezën e përbashkët me temë: “Aspekte të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të Gjykatës Kushtetuese – Paraqitje të elementëve dallues dhe të përbashkët midis Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”.

Tryeza e përbashkët u organizua në Shkup të Maqedonisë.

2 - 6 nëntor 2015

Me përkrahjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i përbërë nga kryetarja znj. Arta Rama-Hajrizi, gjyqtarët, Sekretari i përgjithshëm dhe përfaqësues të Departamentit ligjor, realizoi vizitë studimore në Këshillin e Evropës dhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë.

Gjatë qëndrimit në Strasburg, Kryetarja Rama-Hajrizi dhe delegacioni nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës u takuan me zëvendëskryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, z. András Sajó, si dhe me gjyqtarin z. Ledi Bianku, gjyqtar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i zgjedhur në emër të Republikës së Shqipërisë.

Kryetarja Rama - Hajrizi u takua edhe me kryetarin e Komisionit të Venecias, z. Gianni Buquicchio.



16 - 17 nëntor 2015

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), organizoi punëtorinë me temën: “Hartimi ligjor”, ku ligjërues ishin: Dr. Steffen Wesche dhe Dr. Ingebjorg Darsow Faller.

17 dhjetor 2015

Me përkrahje të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, u organizua një seminar pune me temë: “Neni 8 i Konventës për të Drejtat e Njeriut - përmbledhja, parimet dhe rastet kryesore”. Seminari u mbajt në Prishtinë, ku pjesëmarrës ishin zyrtarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.





Rrahmon Salihu

Programi i praktikës në Gjykatën Evropiane
për të Drejtat e Njeriut

Strasburg

Si pjesë e programit të praktikës së financuar nga Qeveria Zvicerane, me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, kam pasur rastin që të kaloj pesë muaj në Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në selinë e saj në Strasburg, Francë. Gjatë kësaj kohe unë isha caktuar në Divizionin 2.4 dhe kam punuar për Divizionin 4.2 (Divizioni i përpunimit të rasteve shqiptare).

Puna me rastet përfshinte: Rastet me një gjyqtar të vetëm dhe rastet e Dhomës.

Gjatë kohës së qëndrimit tim në GJEDNJ, gjithashtu pata rastin që të marr pjesë në disa konferenca dhe seminare për çështjet e të drejtave të njeriut, të cilat më ndihmuan që të njoftohem me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore të saj, Rregullat e Gjykatës dhe administrimi i përditshëm i saj.

Përveç kësaj, si i trajnuar i GJEDNJ-së, unë mund të merrja pjesë edhe në dëgjime publike të cilat ishin caktuar të mbahen gjatë periudhës së praktikës.

Kjo ishte një mundësi e shkëlqyer për mua që të mësojë nga aspekti organizativ i dorës së parë të një seance publike, prezantimi i argumenteve të palëve, pyetjet nga gjyqtarët e nderuar të GJEDNJ, etj.

Mësimet e nxjerra

Unë i jam mirënjohës para së gjithash Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës, Qeverisë Zvicerane dhe Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, mbështetja bujare e të cilëve më mundësoi që të ndjekë programin e praktikës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

Ka shumë gjëra për t'u mësuar nga procedurat e GJEDNJ-së dhe metodat e punës, duke pasur parasysh përvojën e gjatë të kësaj Gjykate me trajtimin e çështjeve të të drejtave të njeriut.

Pas kthimit nga Strasburgu në Gjykatën Kushtetuese, kam filluar të zbatoj gradualisht metodat e punës në atë masë që ishte e mundur, dhe unë besoj se praktika ka pasur një ndikim të theksueshëm pozitiv në punën time të përditshme në shumë aspekte, siç janë: organizimi i të gjitha procedurave të arritjes në një përfundim, duke përdorur praktikën gjyqësore për situata specifike, metodat e hulumtimit, të hartimit të vendimeve dhe të komunikimit me palët.

Përveç kësaj, së bashku me kolegët e mi nga Gjykata Kushtetuese, ne gjithashtu ndërmorëm hapa për të përmirësuar metodat e praktikës së përpunimit të rasteve. Duke marrë shembullin e seksionit të filtrimit në GJEDNJ, ne kemi themeluar Njësinë e Filtrimit brenda Gjykatës Kushtetuese, e cila është përgjegjëse për të bërë leximin e parë të çdo kërkesë të dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës dhe sugjeron hapat që do të ndërmerren në zgjidhjen e rastit, praktika e mundshme gjyqësore që do të zbatohet, çështjet eventuale të afatit dhe faqet për t'u përkthyer në gjuhë të tjera (zyrtare dhe të punës). Në mënyrë që të lehtësojë këtë proces, ne kemi krijuar një bazë të dhënash të brendshme me informatat e të gjitha rasteve të vendosura nga Gjykata Kushtetuese. Këto informata përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: numrin e kërkesës, emrin e parashtruesit të kërkesës, shkeljeve të pretenduara, llojin e vendimit të marrë, (kur është e papranueshme) arsyen e papranueshmërisë, etj.

Pavarësisht nga fakti se Gjykata Kushtetuese e Kosovës sistematikisht e ndjekë praktikën gjyqësore të Strasburgut dhe ne e citojmë atë në pothuajse çdo rast, është e një rëndësie të madhe kontakti i drejtpërdrejtë, në mënyrë që të kuptojmë plotësisht procesin e trajtimit të një rasti në çdo fazë të procedurës. Pa dyshim që vazhdimi i projektit të vizitave studimore/trajtimeve të kolegëve tonë në GJEDNJ, do të na ndihmojë shumë në punën tonë.



Srdjan Staletovic

Programi i praktikës në Gjykatën Evropiane
për të Drejtat e Njeriut

Strasbourg

Si pjesë e projektit të financuar nga Qeveria Zvicerane, me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, kam marrë pjesë në një Program të Praktikës në Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut në Strasbourg, prej 2 mars 2014 deri më 10 gusht 2014.

Projekti është projektuar për t'u mundësuar këshilltarëve juridikë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës njohjen me metodologjinë e punës së GJEDNJ-së, parimet e saj të përdorura gjatë punës në rastet para Gjykatës, si dhe për të përmirësuar njohuritë ekzistuese në lidhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollat e Konventës.

Në terma praktikë, kjo do të thotë rritje e njohurive tonanënjë nivelmë të lartë, përdorim të metodologjisë dhe të cilësive të punës, duke respektuar të gjitha standardet që mund të aplikohen në rastet e trajtuara nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe rrjedhimisht, ngritje të cilësisë së vendimeve tona.

Projekti ishte i përbërë nga tri pjesë:

Trajnimet në fushën e të drejtave të njeriut

Ligjërata për Konventën e të Drejtave të Njeriut dhe seancat

Puna specifike për rastet në gjykatë

Gjatë punës sime në GJEDNJ kam marrë pjesë në trajnime të ndryshme dhe ligjërata të projektuara dhe të synuara veçanërisht për ne, në mënyrë që të njihemi me Konventën dhe Protokollat e Konventës.

Në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut kam punuar për divizionet ligjore të Malit të Zi, të kryesuar nga avokati i Malit të Zi.

Si një avokat i zyrës së regjistrimit, kam hartuar gjithsej 160 raste të paraqitura në GJEDNJ kundër Malit të Zi.

Mësimet e nxjerra

Do të doja të shpreh mirënjohjen time të thellë për Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të gjithë gjyqtarët e Gjykatës, Qeverinë Zvicerane dhe Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, mbështetja bujare e të cilëve bëri të mundur që unë të ndërmarrë një punë profesionale prej 5 muajsh në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasbourg.

Koha ime në GJEDNJ ka zgjeruar shumë njohuritë e mia ligjore, në mënyrë të cilat janë të mundshme vetëm nëpërmjet përvojës së drejtpërdrejt në praktikë, dhe më dha një pasqyrë unike për punën dhe metodat e punës së kësaj Gjykate, e cila do të ketë vlerë të paçmueshme për karrierën time, si avokat i të drejtave të njeriut.

Njohuritë profesionale që i kam fituar gjatë trajnimeve dhe ligjëratarave, si dhe përvoja që e kam fituar duke punuar në raste të veçanta, më ndihmoi që t'i çojë përpara dhe t'i zgjerojë njohuritë e mia në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe të studiojë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore nga këndvështrime të ndryshme.

Njohuria, praktika dhe përvoja e fituar në një mënyrë të tillë, më mundësojnë që ta rrisë cilësinë e punës gjatë trajtimit të rasteve të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese, si dhe të bëjë një analizë më të mirë dhe më koncize të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, për shkelje të pretenduara të të drejtave që janë të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

1. Seanca Plenare e 106-të e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës

Datë: 11.03.2016 - 12.03.2016

Venecia - Scuola Grande di San Giovanni Evangelista.

2. Konferenca Botërore për Drejtësinë Kushtetuese

Datë: 12.03.2016

Venecia - Konferenca Botërore për Drejtësi Kushtetuese do të mbajë një mbledhje të Byrosë së saj.

3. Rumani - Konferenca e 13-të Evropiane e Organeve Drejtuese Zgjedhore

Datë: 14.04.2016 - 15.04.2016

Bukuresht - Komisioni i Venecias do të bashkë-organizojë Konferencën e trembëdhjetë evropiane të organeve drejtuese zgjedhore në bashkëpunim me Autoritetin e Përhershëm Zgjedhor të Rumanisë.

4. Poloni – Drejtësia Kushtetuese

Datë: 19.05.2016 - 20.05.2016

Varshavë –Konferenca Ndërkombëtare për «Gjykatën Kushtetuese: Mbrojtja dhe Ruajtja Realitetet e Ligjit dhe të Drejtave Themelore» me rastin e 30 vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Polonisë.



5. Drejtësia Kushtetuese – Këshilli i Përbashkët

Datë: 07.06.2016 - 08.06.2016

Venecia - Takimi i 15-të i Këshillit të Përbashkët të Drejtësisë Kushtetuese të Komisionit të Venecias.

6. Seanca Plenare e 107-të e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës

Datë: 10.06.2016 - 11.06.2016

Venecia - Scuola Grande di San Giovanni Evangelista.





Aktgjykim:

KI 144/14 dhe KI 156/14

7 gusht 2015

Parashtrues:

Vilijamin Hajduković dhe Stanka Tus

Ndërmjet periudhës 1 korrik dhe 31 dhjetor 2015, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 188 kërkesa/lëndë.

Gjithsejtë 87 kërkesa janë zgjidhur ose 46.3% e të gjitha rasteve në disponim, prej të cilave vetëm 3 kanë qenë aktgjykime.

Më poshtë mund të lexoni një përmbledhje të shkurtër të dy prej aktgjykimeve më me rëndësi që u miratuan:


KI 144/14 dhe KI 156/14, Parashtrues Vilijamin Hajduković dhe Stanka Tus, Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të dy vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, përkatësisht Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006

Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore kishte nxjerrë dy aktgjykime të formës së prerë lidhur me të drejtat e parashtruesve mbi pronat e paluajtshme. Këto vendime ishin nxjerrë në favor të dy parashtruesve të kërkesës duke ua njohur të drejtat e tyre pronësore mbi pronat e paluajtshme të kontestuara. Megjithatë, për më shumë se 14 vjet vendimet në fjalë nuk ishin ekzekutuar nga Agjencia Kosovare e Pronës - autoritet - përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të nxjerra nga Komisioni i Kërkesave Pronësore dhe Banesore.

Parashtruesit e kërkesës pretenduan inter alia se për shkak të mospërmbarimit të aktgjykimeve të formës së prerë dhe të detyrueshme në dobi të tyre janë shkelur të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe gëzimit paqësor të pronave siç garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht me Konventën për të Drejta të Njeriut.

Gjykata së pari vlerësoi se kërkesa e parashtruesve i përmbush të gjitha kriteret procedurale dhe, prandaj, është e pranueshme. Sa i përket meritave të kërkesës, Gjykata konstatoi se mospërmbarimi i vendimeve të Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore nga Agjencia Kosovare e Pronës dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas për përmbarimin e vendimit të formës së prerë, është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Në këto rrethana, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë në lidhje me të drejtën për gëzim paqësor të pronës. Gjykata e mbështeti konstatimin e saj duke u bazuar në praktikën e saj gjyqësore për rastet e ngjashme dhe në praktikën relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut.





Aktgjykim

KO 130/15,

23 dhjetor 2015

Parashtrues:

Presidentja e Republikës së Kosovës

Presidentja e Republikës së Kosovës - Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Presidentja e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84 (9) e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kërkesa ishte dorëzuar lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Para se të ofrojë përgjigje thelbësore ndaj çështjeve të veçanta kushtetuese të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata vendosi pozitivisht lidhur me dy çështje procedurale duke deklaruar se parashtruesja është palë e autorizuar dhe se dokumenti i përmbajtur në kërkesë mund t'i nënshtrohet vlerësimit kushtetues. Gjykata shtjelloi historikun e dokumentit në shqyrtim pikërisht duke iu referuar Marrëveshjes së Parë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe për më tepër kërkoj mendimin e dy ekspertëve ligjorë me anë të parashtrësës Amicus Curiae.

Sa i përket aspektit material të kërkesës, Gjykata Kushtetuese gjeti se disa parime të përgjithshme të përfshira në dokumentin nën shqyrtim kushtetues nuk plotësojnë në tërësi standardet kushtetuese të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjykata deklaroi se çdo legjislacion apo dokument që rrjedh nga dokumenti në shqyrtim kushtetues duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht: (i) Kapitujt II dhe III të Kushtetutës në lidhje me të drejtat themelore të njeriut dhe të drejtat e komuniteteve, (ii) çështje të vetëqeverisjes lokale dhe çështjet që kanë të bëjnë me statusin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës. Gjykata mbështeti arsyetimin e saj duke u mbështetur kryesisht në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, legjislacionin për çështjet e vetëqeverisjes lokale dhe shërbimit civil, respektivisht, instrumentet e ndryshme ndërkombëtare ligjore, praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut.



Përkitazi me palët që janë të autorizuar për të parashtruar kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese, bazuar në Nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:
 - (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
 - (2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.
3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:
 - (1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
 - (2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;
 - (3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;
 - (4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
 - (5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.
4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.
5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.
6. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.
9. Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.
10. Juridiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj.



Si fillon procedura para gjykatës?

Fillimi i procedurës në Gjykatën Kushtetuese bëhet përmes paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Kërkesa parashtrohet duke e plotësuar formularin e kërkesës, të cilin mund ta shkarkoni nga ueb-faqja e Gjykatës ose ta kërkonti drejtpërdrejt në Gjykatë (edhe pse kjo mund t'ju marrë më shumë kohë).

Para se ta plotësoni formularin e kërkesës, ju lutemi që të konsultoni “Udhëzimet” për plotësimin e formularit, të cilin mund ta gjeni gjithashtu në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese.

Pasi ta keni plotësuar formularin e kërkesës, ju duhet ta dorëzoni atë personalisht në Gjykatë, gjatë orarit të rregullt të punës, ose nëpërmjet postës së rregullt apo me postë elektronike (e-mail). Kërkesat duhet të jenë të arsyetuara dhe atyre duhet t'u bashkëngjiten provat dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme (mos i dorëzoni dokumentet origjinale për shkak se ato nuk do t'ju kthehen pas përfundimit të shqyrtimit të lëndës). Çfarëdo pyetje në lidhje me këtë mund ta drejtoni në adresën elektronike: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org.

Çfarë është procedura para Gjykatës?

Në rast se Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkesa është e lejueshme, ajo do të kërkojë nga pala tjetër të parashtrojë përgjigjen apo dokumentet e saj të ndërlidhura me kërkesën. Mungesa e përgjigjes nga pala tjetër nuk ndikon në procedurën para Gjykatës Kushtetuese. Procedura zhvillohet në formë të shkruar. Sidoqoftë, Gjykata mund të vendos të mbajë shqyrtim publik kur të jetë e nevojshme, që të shqyrtohen çështje të rëndësishme për marrjen e vendimit. Parashtruesi i kërkesës mund ta paraqet rastin e tij/saj para Gjykatës Kushtetuese apo mund ta përcaktojë personin i cili do ta përfaqësojë atë. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës këshillohet të angazhojë avokat për të përfaqësuar lëndën e tij. Kërkohet nga përfaqësuesi i juaj ta paraqesë autorizimin me shkrim.



Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuar në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është ndërtimi i sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimi i Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011. Ky objekt ka gjithsej 784 m2 dhe shfrytëzohet nga 65 punonjës të Gjykatës.



ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10000, Prishtinë

Tel: +381 (0)38 60 61 62

Mob: +377 (0)45 200 595; +377 (0)45 200 576

Fax: +381 (0)38 60 61 70

Ueb: www.gjk-ks.org

E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org